



ETAT DE FRIBOURG
STAAT FREIBURG

Direction de l'instruction publique, de la culture et du sport DICS
Direktion für Erziehung, Kultur und Sport EKSD

Rue de l'Hôpital 1, 1701 Fribourg
www.fr.ch/DICS

Réf: JPS/JFB/MMG/cc
T direct: +41 26 305 12 27.
Courriel: SEenOF@fr.ch

Fribourg, më 4 maj 2020

Rikthimi në bankat e shkollës të nxënësve të shkollës së detyruar

Këtë që po jetojmë që në mes të muajit të marsit, ishte gati e pa imagjinueshme : ndalimi i mësimdhënies në klasat e shkollës, deklarimin e situates extraordinare nga Këshilli federal, ndalja e tregjeve, ndalimi i grupimeve të ndryeshme. Përballë kësaj situatë të jashtëzakonshme të pashembulltë, shumë vendime u morën nga Këshilli I Shtetit dhe nga Këshilli federal në mënyrë që të mbrojnë popullësinë dhe të garantojnë të gjithëve dhe akoma në veçanti personave në rrezik një mjekim dhe përkujdesje për periudhën e duhur.

Duke qënë se është përmirësuar situata shëndetësore, Këshilli federal konfirmoi rikthimin e mësimdhënies në presencë (në klasat shkollore) në shkollën e detyruar duke filluar nga data 11 maj 2020.

Ne kemi kënaqësinë t'ju mirëpresim fëmijën tuaj së shpejti në strukturat tona shkollore, me qëllim që të rimarrim mësimdhënjen « në direkt ». Kjo rimarrje e mësimdhënies do bëhet në respekt të principeve të parashikuara në planin e mbrojtjes të përpunuar nga Zyra federale e shëndetit publik.

Dijeni që kthimi i nxënësve në klasa përgatitet me bashkëpunimin e ngushtë me Organin kantonal të drejtimit (OCC) dhe që do jetë gradual. Kështu :

Shkolla primare (1H-8H)

Që nga e hëna e 11 majit, rikthimi në shkollën e detyruar për ciklin 1 dhe 2 do të bëhet me gjysmën e klasës dhe do të zgjasë për dy javë. Kjo alternancë do të lejoj mësuesve dhe nxënësve që të gjenden në grupe më të vogla derisa të rikrijnë lidhjet dhe të përshtaten me rregullat e higjienës për ti vënë në fuqi dhe ti respektojnë në kontekstin shkollor. Nga e hëna e 25 majit, të gjithë nxënësit e shkollës primare do të ndjekin shkollën komplet në klasë. Drejtorja e shkollës në bashkëpunim me mësuesit do ju informojë me shkrim për organizimin e stabilizuar për kthimin në klasa.

Cikli i orientimit (9H-11H)

Të gjithë nxënësit të ciklit të orientimit do të rigjejnë klasën e tyre më datë 2 qershor : mësimdhënia në distancë do vazhdoj deri më datë 27 maj. Cdo drejtori e shkollës do të vërë në dispozicion një autonomi për organizimin e një rikthimi në bankat e shkollës progresiv më datë 28 dhe 29 maj.

Aktivitetet e para do të lejojnë shkëmbimin në periudhën e mësimdhënies në distancë dhe të mbikqyrin që rregullat e higjienës të jenë të kuptuara mirë dhe të aplikuar në mënyrë korrekte që në momentet e para të rikthimit në shkollë. Drejtimi i CO do ju informoj me shkrim mbi mënyrat e fiksuara për kthimin në bankat e shkollës.

Plani i mbrojtjes

Rikthimi në bankat e shkollës, i ndryshëm për çdo cikël, do lejojë DICS, OCC, shërbimin e mjekut kantonal dhe autoritetet kompetente, të finalizojnë planet e ndryshme të mbrojtjes që janë të nevojshme dhe të vënë në vijë një seri shërbimesh për funksionimin e mirë të strukturave. Janë këto elementet që folëm më sipër :

- > plan i mbrojtjes për shkollën e detyrueshme ;
- > plan i mbrojtjes për shkollën e specializuar ;
- > plan i mbrojtjes për transportin shkollor protection pour les transports scolaires ;
- > plan i mbrojtjes për mençat (kantinën) shkollore.

Hotline kantonal

Hotline kantonal « Vie quotidienne- Jeta e përditshme » (026 552 6000) qëndron në dispozicionin tuaj për pyetje të paqarta për mësuesi-e-t dhe për drejtoritë e strukturave.

Disa informacione mbi aktualitetin

Nga data 14 mars ne vëmë në dispozicionin e publikut informacione lidhur me shkollën dhe i axhornojmë ato rregullisht. Keto informacione mbi aktualitetin gjenden në adresën :

www.fr.ch/dics

Mësuesit, drejtorët e shkollës dhe shërbimet e mësimdhënies punojnë së bashku për një kthim normal, me të gjitha gjestet e higjenes që ekzistojnë që në fillimet e muajit të marsit në shkolla.

Po ju ritheksoj , të dashur Prindër, faleminderimet më të sinqerta për bashkpunimin e çmuar që ju keni treguar këto javët e fundit dhe shkollimi i fëmijëve është bërë te ju dhe në distancë, falë pranisë tuaj. FALEMINDERIT.

Duke ju dërguar mesazhet e mia më të mira,

Jean-Pierre Siggen
Këshilltar i Shtetit, Drejtor